



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR**

UDHËZIM PLOTËSUES

13.7.17

10089/15

Nr. 10/3 Datë 13.7.2017

**PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2018-2020**

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 neni 27, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe pikës 78 të Udhëzimit nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ministri i Financave:

U D H Ë Z O N:

I. Përgatitja e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar

1. Njësitë e Qeverisjes Qendrore të përgatisin dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar. Ky dokument të ri-punohet mbështetur në tavanet e shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, të miratuara me VKM nr.197, datë 15.3.2017 si dhe, analizave të përcjellë nga Ministria e Financave mbi cilësinë e dokumentit të përcjellë në fazën e parë.
2. Kërkesat e rishikuara buxhetore 2018-2020 të përgatiten në zbatim të Udhëzimit nr.23 datë 22.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programimit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhëzimit nr.10 datë 29.02.2017 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019” dhe të këtij Udhëzimi Plotësues.
3. Përgatitja e kërkesave të rishikuara duhet të mbajë në konsideratë:
 - Për institucionet qendrore, të cilat nuk kanë akses në softin e Programit Buxhetore Afatmesëm, duhet detyrimisht të paraqesin kërkesat buxhetore nëpërmjet formateve standarde të rishikuara në EXCEL, të cilat shkarkohen në link-un:
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>.
 - Deklarata e Politikës së Programit dhe Raporti i Objektivave të Synuar pjesë e formateve të rishikuara në EXCEL, do të plotësohen sipas këtij standarti dhe nga njësitë e qeverisjes qendrore që kanë akses në softuerin e Programit Buxhetor Afatmesëm, deri në momentin e rishikimit të softit në përputhje me ndryshimet e bëra për Deklaratën e Politikës së Programit në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016.
 - Pjesë integrale e Deklaratës së Politikës së Programit 2018-2020, për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore do të jenë dhe treguesit e performancës për çdo objektiv të programit. Treguesit e performancës përkufizohet si tregues sasiorë/cilësorë të synuar që masin progresin e bërë në përmbushjen e qëllimit dhe objektivave.

- ✓ Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave do të shërbejnë krahas produkteve të planifikuara dhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këtu mund të përfshihen standarte të njohura të fushës; tregues statistikorë; indekse kombëtare e ndërkombëtare të fushave të ndryshme etj. Njëkohësisht, për ata tregues performance të cilët nuk vlerësohen mbi bazë vjetore por disa vjeçare (psh vlerësime ndërkombëtare të tilla si: OBI, PISA score, PEFA score), si nivel i vitit aktual vendoset niveli më i fundit i regjistruar për ta.
 - ✓ Një objektiv mund të ketë një ose më shumë tregues performance.
4. Të gjithë Njësitë e Qeverisjes Qendrore, në **Fazën II** të Programit Buxhetor Afatmesëm, krahas raporteve standarte të kërkesave buxhetore duhet të ri-plotësojnë dhe dorëzojnë në Ministrinë e Financave pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit vjetor 2018 sipas Shtojcës 1/A, të udhëzimit nr.10, datë 29.02.2017. Formatet standarte dhe pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit mund të shkarkohet dhe në linkun: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>
 5. Në kuadër të përgatitjes së projektbuxhetit të vitit 2018, dhe në vijim të zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, nga Kuvendi dhe institucionet e përfshira në këtë reformë, të paraqitet informacion mbi:
 - ✓ Institucionet buxhetore të krijuara në bazë të ligjeve të miratuara të reformës dhe shpenzimet e domosdoshme për funksionimin e tyre.
 - ✓ Institucionet buxhetore që parashikohen të krijohen apo ri-strukturohen gjatë vitit 2018 me miratimin në vijim të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, duke paraqitur dhe një vlerësim paraprak financiar të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimit e tyre.
 - ✓ Me qëllim unifikimin e formës së paraqitjes së informacionit, sugjerojmë plotësimin e informacionit sipas formateve të shtojcës 1/A “Pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit 2018” për çdo institucion.
 6. Për planifikimin e investimeve të programit, Njësitë e Qeverisjes Qendrore duhet t’i referohen **Shtojcës 2** dhe formularëve përkatës në **Shtojcat 2/A dhe 2/B** deri në momentin e miratimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për procedurat e menaxhimit të investimeve publike. Formularët në shtojcat 2A dhe 2B duhet të plotësohen dhe dorëzohen në Ministrinë e Financave, si edhe mund të shkarkohen së bashku me shtojcën 2 në link-un: <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/udhezime>
 7. Në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, të gjitha ministritë e linjës duhet të përcaktojnë si dhe, rishikojnë në rastet kur është e nevojshme, objektiva/produkte/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore, duke mbajtur në konsideratë dhe komentet e bëra në përfundim të fazës së parë të PBA 2018-2020.
 8. Në rastet kur tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm nuk përmbushin nevojat më të domosdoshme, Njësitë e Qeverisjes Qendrore mund të paraqesin kërkesa shtesë, sipas procedurës përkatëse të ilustruar në **Shtojcën nr.3** (seksioni H - Kërkesat Shtesë të Programit Buxhetor Afatmesëm) të Udhëzimit nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”
 9. Kurset e Këmbimit për vitet 2011-2017 dhe parashikimi për vitet 2018-2020 që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2018	2020
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	100.9	108.2	105.7	105.5	126.0	124.1	124.1	124.1	124.1	124.1
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	140.5	139.0	140.3	140.0	139.7	137.4	137.4	137.4	137.4	137.4

II. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar

- a) Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2017, të detyrueshme për t'u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:
- Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 për **Fazën II, është deri më datë 1 shtator 2017;**
 - Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, për **Fazat e II**, paraqiten në **Tabelën nr.2**, bashkëlidhur Udhëzimi nr.10, datë 29.02.2017. Përkatësisht në periudhat **18 shtator – 29 shtator 2017**, Ministria e Financave do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësive të Qeverisjes Qendrore. Në këto seanca do të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësues nga Departamenti i Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, Ministria e Integritimit Evropian, si dhe një përfaqësues për çështjet gjinore nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në rolin këshillimor, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 të dërguara prej tyre. Në këto seanca do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas fushave përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve të sipërcituara, të cilat do të përfshihen në raportin përmbledhës të përgatitur nga Ministria e Financave, raport i cili u dërgohet zyrtarisht Njësive të Qeverisjes Qendrore.
- b) Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

III. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do të raportohet rregullisht nga ministri i Financave tek Këshilli i Ministrave.
- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore adresën email: budget.programming@financa.gov.al.

HELGA VUKAJ

MINISTËR